

VENDIM
Nr. 130, datë 17.02.2016

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 289, DATË 17.5.2006, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË SË LEGALIZIMIT, URBANIZIMIT DHE INTEGRIMIT TË ZONAVE/NDËRTIMEVE INFORMALE (ALUIZNI)”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 46, të ligjit nr. 9482, datë 16.2.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 289, datë 17.5.2006, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. ALUIZNI ka Drejtorinë e Përgjithshme në Tiranë dhe drejtori varësie në çdo qendër qarku. Përgjithësisht, në qarqet Durrës, Fier dhe Vlorë, ALUIZNI ka përkatësisht dy drejtori, si dhe në Tiranë shtatë drejtori varësie.”.

2. Pas pikës 4 shtohet pika 4/1 me këtë përmbajtje:

“4/1. Në përputhje me organikën dhe strukturën e miratuar sipas pikës 4 të këtij vendimi, drejtori i Përgjithshëm i ALUIZNI-t përcakton kompetencat territoriale dhe/ose lëndore të drejtorive të qarqeve Durrës, Vlorë, Fier dhe Tiranë.”.

Kudo në vendim emërtimi “Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit”, zëvendësohet me “Ministria e Zhvillimit Urban”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama